

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

Tema

**STATUSI ANTROPOMETRIK DHE MOTORIK TEK FUTBOLLISTËT E
GRUPMOSHAVE 12-13 VJEÇARE TË SHKOLLAVE TË FUTBOLLIT TË
REGJIONIT TË PRIZRENIT**

MENTORI:

Prof. Asoc. Dr. Bylbyl Sokoli

KANDIDATI:

Alfred Cena

Prishtinë, Janar - 2017

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
1.1 <i>HULUMTIMET E DERITANISHME</i>	7
2. QËLLIMI I PUNIMIT	9
3. HIPOTEZAT THEMELORE	10
4. METODAT E HULUMTIMIT	11
4.1 <i>PËRKUFIZIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT</i>	11
4.2 <i>NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE</i>	12
4.3 <i>NDRYSHORET MOTORIKE</i>	12
4.4 <i>PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE</i>	13
4.4.1 <i>Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike</i>	13
4.4.2 <i>Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike</i>	18
4.5 <i>MËNYRA E ZBATIMIT TË HULUMTIMIT</i>	26
4.6 <i>METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE</i>	27
5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI	28
5.1 <i>PËRSHKRIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR</i>	28
5.1.1 <i>Përshkrimi i parametrave themelor statistikor Sh.f. 'BALLKANI' Therandë</i>	28
5.1.2 <i>Përshkrimi i parametrave themelor statistikor Sh.f. 'DRINI I BARDHË' Prizren</i>	30
5.1.3 <i>Përshkrimi i parametrave themelor statistikor Sh.f. 'LIRIA' Prizren</i>	32
5.1.4 <i>Përshkrimi i parametrave themelor statistikor Sh.f. 'RAHOVER' Rahovec</i>	34
6. KOEFICIENTËT E KORELACIONIT NË MES NDRYSHOREVE MORFLOGJIKE DHE MOTORIKE	36
6.1 <i>KOEFICINETËT E KORELACIONIT TË NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE TE FUTBOLLISTËT E RINJË TË SH.F. 'BALLKANI' THERANDË</i> ..	36
6.2 <i>KOEFICINETËT E KORELACIONIT TË NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE TE FUTBOLLISTËT E RINJË TE SH.F. 'DRINI I BARDHË' PRIZREN</i>	38
6.3 <i>KOEFICIENTËT E KORELACIONIT TË NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE TE FUTBOLLISTËT E RINJË TË SH.F. 'LIRIA' PRIZREN</i>	40
6.4 <i>KOEFICIENTËT E KORELACIONIT TË NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE TË FUTBOLLISTËT E RINJË TE SH.F. 'RAHOVER' RAHOVEC</i>	42
6.5 <i>DALLIMI SIPAS EKIPEVE NË NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE</i>	44
6.5.1 <i>Dallimi në mes të ekipeve te futbollistët e rinjë të moshës 12-13 vjeçarë</i>	44
6.5.2 <i>Dallimi në mes çdo ekipi te futbollistët e rinjë të moshës të moshës 12-13 vjeçarë</i>	46
6.6 <i>VËRTETIMI I HIPOTEZAVE</i>	52
7. PËRFUNDIMI	53
8. LITERATURA	55

1. HYRJE

Në kohën e fundit kushtet e tanishme të jetesës dhe punës bëjnë që futbolla si sport ekipor të paraqet fushë shumë të rëndësishme në të cilën sportisti në mënyrë specifike mund ti shprehi si dhe ti tregojë në mënyrë specifike krijimtaritë e veta specifike lëvizore. Mendohet se njëri ndër motivet kryesore i cili i lëvizë dhe i kyç njerëzit që të merren me sport, është synimi ose pretendimi për mësuarijën, përsëritjen dhe përsosjen e aftësive lëvizore, pastaj organizimin më të mirë të procesit stërvitor, që ai të kuptohet si qëllim i ruajtjes dhe avancimit të shëndetit.

Si në lojërat e tjera sportive apo ekipore sportive, në futboll suksesi varet nga shumë faktorë të ndërlikuara dhe të ndërlidhura:

1. Përgatitjes teknike
2. Përgatitja taktike dhe vendim-marrjes në lojë
3. Përgatitja fizike
- 4 Përgatita psikologjike dhe rezistenca mendore
- 5 Karakteri dhe aftësitë e komunikimit
- 6 Strategjia dhe plani i lojës

Lojrat sportive mund të klasifikohen në (1) Zotërimit (engl. Invasion games), (2) lojërat në rrjetë ose në mur (engl. neto / Wall games), (3) Goditëse (engl. Striking/Fielding games) dhe (4) lojërat me objektiv (engl. Target games). Futbolla bënë pjesë në lojërat zotëruese që karakterizohet me lojë me top dhe pa top, me lojë në mbrojtje, mesfushë dhe sulm.

Lojrat – Zotruese	Lojrat - Rrjetë/Mur	Lojrat - Goditëse	Lojrat - Objektiv
Basketbolli Hendbolli Vaterpolo Futbolli Ragbi Futbolli Amerikan Hokej	Volejbolli Badminton Tenis Ping-pongu	Bejzbol Softbol Kriket	Golf Kuglimi Biliar Snuker Lojë me birila Golf

Gjatë aktiviteteve garuese përgatitja kondicionale, teknike, taktike si dhe fushat tjera të përgatitjes së futbollistëve paraqesin tërësin e ndërlikuar dhe integrale dhe asnjëherë nuk shprehen ndarasi. Të gjitha drejtimet e përmendura të përgatitjes sportive në një masë varet nga niveli dhe

struktura e drejtimeve tjera të përgaditjes së sportistëve, dhe në këtë mënyrë së bashku ndikojnë në arritjen e rezultateve maksimale kulminante. Kështu për shembull, përgaditja teknike e sportistëve në lojën e futbollit në masë të madhe varet nga shkalla dhe aftësit antropometrike dhe motorike. Me fjalë të tjera është e pamundur që futbollistin në mënyrë kualitative ta përgatisim në pikëpamje teknike nëse ai nuk posedon aftësi motorike të cilat janë të domosdoshme për realizimin e elementeve teknike të theksuara siç janë për shembull, forca, shpejtësia, koordinacioni, fleksibiliteti qëndrueshmëria etj. Në anën tjetër vetëm përgatitja e mirë teknike mundëson futbollistit ti shprehë plotësisht këto aftësi kondicionale në stërvitje dhe gara. Njëkohësisht niveli dhe struktura e qëndrueshmërisë specifike është e lidhur ngusht me realizimin ekonomik të teknikës, me zhvillimin e cilësive specifike psikologjike të futbollistit siç janë toleranca e ngarkesës dhe lodhjes dhe aftësia e realizimit të detyrave taktike të thjeshta dhe të ndërlikuara në kushtet e lojës. Efikasiteti i zgjedhjes së teknikave të mësuara është e kushtëzuar me aftësitë e caktuara kondicionale dhe në anën tjetër me aftësitë e futbollistit për pranimin, përpunimin dhe shfrytëzimit të informacioneve taktike, vendosshmërin e tij dhe shpejtësisë së gjetjes së zgjidhjeve në problemet taktike të cilat lajmërohen në lojë

Përgatitja integrale mundëson lidhshmërin e të gjitha aftësive, njohurive dhe cilësive gjatë lojës. Harmonizimi i të gjitha elementeve kondicionale, teknike, taktike dhe përgatitjes psikologjike paraqesin pjesën më të rëndësishme të adaptimit sportiv për pjesëmarrje të suksesshme në gara.

Nuk guxon të ndodhë që aftësitë, cilësitë dhe njohuritë të cilat kanë funksionuar në ndonjë segment të ndarë të përgatitjes të mos lajmërohen në aktivitetet garuese, respektivisht, që të mos jenë të integruara në të. Mënyra sintetike, respektivisht, situacionale e stërvitjes gati gjatë stërvitjes në periudhën përgatitore bashkon disa faktorë të përgatitjes në efikasitetin e përbashkët garues. Për këtë arsye kjo mënyrë e stërvitjes më e mira për përsosjen integrale të sportistit brenda sistemit të sporteve ekipore respektivisht të futbollit. Lidhshmëria e përgatitjeve të llojeve të ndryshme është e kushtëzuar me qëndrimin specifik të nivelimit të procedurave metodike dhe programimit të përgatitjes kondicionale, taktike dhe teknike në ciklin shumëvjeçar dhe njëvjeçar të stërvitjes në lojën e futbollit.

Përgaditja kondicionale është proces i ndërlikuar dhe gjithpërfshirës i aplikimit të programeve të ndryshme për zhvillimin dhe mbajtjen e aftësive funksionale dhe motorike si dhe karakteristikave morfologjike të futbollistëve. Detyra themelore e këtyre programeve qëndron në përparimin e stërvitjes dhe rezultateve sportive, rritjen e cilësive dhe aftësive të përgjithshme, bazike dhe specifike të cilat janë të domosdoshme për ekzekutimin me sukses të aktiviteteve

stërvitore dhe garuese. Përgaditja kondicionale duhet të jetë e kuptuar si proces afatgjatë i të ushtruarit në të cilën përherë ndryshohen ngarkesat dhe pushimet, stresi dhe adaptimi në ngarkesa. Në aftësitë kondicionale mund të veprojmë në dy mënyra, respektivisht mund të zhvillojmë dyfishë në mënyrë analitike duke e zhvilluar çdo njëren veç e veç ose zhvillimin sintetik - zhvillimi bashkues i shumë aftësive në përgaditjen e përbashkët kondicionale. Qëndrimi analitik i zhvillimit të aftësive motorike në sportet kolektive, konkretisht në sportin e futbollit është i arsyeshëm nëse sportisti tregon deficit të theksuar në zhvillushmërinë e disa aftësive konkretisht motorike dhe se në të gjitha rastet tjera është larg më efikas stërvitja kondicionale në aspektin e trajtimit sintetik.

Me qëllim të kontrollit të përhershëm të realizimit të stërvitjes kondicionale dhe efekteve të tyre është i domosdoshëm zhvillimi i aftësive funksionale dhe motorike i sportistëve përherë të kontrollohen dhe të përcjellën çka do të siguron përsëritjen e cikleve të suksesshme stërvitore dhe rezultateve të arritura.

Aftësitë motorike dhe funksionale janë parakushte të domosdoshme për çdo lloj të lëvizjes së njeriut e për këte edhe për çdo aktivitet kineziologjik ose aktivitet sportiv. Kohëzgjatja, intensiteti, dhe numri i përsëritjeve i strukturave të ndryshme lëvizore, përcaktojnë rëndësinë e disa aftësive kondicionale. Është e njohur që sa më i ndërlikuar të jetë aktiviteti sportiv sipas strukturës së lëvizjes tek ajo paraqitet numër më i madh i aftësive të ndryshme motorike dhe funksionale.

Ekzekutimi i elementeve teknike në sportet ekipore, konkretisht në lojën e futbollit kërkon nivel të caktuar të përgaditjes dhe strukturën e aftësive kondicionale. Kështu për shembull, aftësia e shpejtësisë dhe e forcës japin mundësi më të mëdha të suksesit në lojën e futbollit, më konkretisht thënë, lëvizshmëria e ekstremiteteve të poshtme mundëson plasimin e goditjeve precize. Në vazhdim, përgaditja e mirë kondicionale do të prolongojë dukurinë e lodhjes lokale dhe lodhjen e sistemit nervor qendror dhe kështu edhe kontribon në zvoglimin e gabimeve motorike në ekzekutimin e elementeve teknike.

Teknika e ekzekutimit të elementeve në lojën e futbollit ka ndikim të dukshëm në shfrytëzimin e aftësive kondicionale të sportistit. Njohuritë teknike mundësojnë shfrytëzimin racional të potencialeve biologjike të sportistit. Është e njohur që koordinimet e mira dhe ekzekutimet e drejta të teknikave brenda lojës së futbollit në masë të dukshme zvoglon aktivizimin dhe rezervat energjetike të sportistit i cili ekzekuton teknikën përkatse.

Kjo është e një rëndësie të vacant nëse dijmë që mosekzistimi i aftësive adekuate kondicionale tek futbollistët në momentin konkret, i krijohet mundësia kundërshtarit të tij për shrytzimin efikas të njohurive teknike dhe kontrollin e suksesshëm të rrjedhës së lojës. Kjo

praktikisht do të thotë se sportistët kondicionalisht me përgaditje të lartë në kushtet stresore të garave nën ndikimin e presionit të lartë të rezultatit mund ta mbajnë nivelin e lartë të koncentrimit, sigurisë dhe veprimit kualitativ tekniko-taktik.

1.1 HULUMTIMET E DERITANISHME

Janë të shumta hulumtimet e hapësirës antropometrike dhe motorike, i kemi veçuar disa më të rëndësishme dhe më të njohura që lidhen me natyrën e problemit që kemi për shqyrtim.

Gabrieliq, M. (1972) ” Disa aftësi psikomotorike situacionale, potenciale dhe aktuale dhe të rëndësishme për suksesin e fëmijëve në lojën e futbollit ” Rezultatet e hulumtimit kanë treguar nivel të kënaqshëm të predikcionit të suksesit në lojë me ndihmën e testeve të aplikuara.

Elesner, B. (1973) “ Punim i Magjistratures” ka izoluar dy dimensione autotrimetrike dhe motorike në mostrën e futbollistëve të rangut të dytë federative dhe Republikane të Sllovenis, dimensionet e izoluar antropometrike: Dimensioi skeletor, dimensionet qarkor i ekstremiteteve të poshtme, dimensionet motorike: forca eksplozive, forca izometrike e kofshës dhe e pjesës abdominale, forca izometrike e shtrirjes dhe mbledhjes së gjunjëve.

Sokoli, B. (2001) Bënë një hulumtim me futbollistë të moshës 13 vjeqare me një mostër prej 98 futbollistësh duke bërë hulumtime tek të dy hapsirat standarde hulumtuese të kësaj natyre, në hapsirën e antropometris dhe motorikës dhe si rrjedhojë në hulumtimin e tij ka veçuar këta faktor:

- Faktori i vëllimit dhe masës trupore
- Faktori longitudinal i dimensionit skeletor
- Faktori agjilitetit dhe lëvizjes së teknikës
- Faktori i forcës eksplozive dhe shpejtësisë

Autori vjen në përfundimin se treguesit antropometrik deri diku kanë rol në parashikimin e rezultateve në shumicën e ndryshoreve motorik, andaj parametrat antropometrikë duhet merren parasysh tek rastet e seleksionimit dhe orientimit për futboll tek fillestarët në moshat e reja.

Gjinolli, E. Sokoli, B. (2000) Kanë hulumtuar ndikimin e programit të mësimin të futbollit përmes 8 ndryshoreve të motorikës specifike me anë të dy matjeve (iniciale dhe finale) në mostrën prej 30 studentëve të vitit të dytë të Fakultetit të Kulturës Fizike të Prishtinës, vijues të mësimin të rregullt të lëndës së futbollit. Qëllimi i hulumtimit ka qenë përcaktimi i ndryshimeve të dimensioneve të motorikës specifike të studentëve të vitit të dytë të FKF-ës, nën ndikimin e programit mësimor të futbollit. Me analizë diskriminative kanonike të hapësirës motorike specifike të lojës së futbollit janë fituar dallime të rëndësishme mes dy matjeve (matjes së parë dhe të dytë) në favor të matjes së dytë.

Bahtiri, A. (2001), në mostrën prej 310 individëve, ka hulumtuar lidhmërinë e hapësirës antropometrike dhe disa variabla të vrapimit të shpejtësisë, si dhe ka vërtetuar strukturë latente të

dy hapësirave. Ka konstatuar se ekziston lidhshmëri statistikisht e vlefshme ndërmjet parametrave morfologjikë dhe atyre motorikë, por ajo lidhshmëri nuk është e lartë.

Rexhepi, A. (2008), në Doracakun Antropologjik ka paraqitur të dhënat antropometrike për popullatën e grup-moshave prej 7 deri në 19 vjeçare, dhe ka konstatuar se një formë e stabilitetit të ndryshoreve antropometrike të matura arrihet në moshën 16-17 vjeçare.

Në bazë të këtij hulumtimi studiuesi vjen në përfundim se treguesit antropometrikë, deri diku kanë ndikim të caktuar në parashikimin e rezultateve në shumicën e ndryshoreve motorike, andaj parametrat antropometrikë duhet të merren parasysh me rastin e seleksionimit të futbollistëve të rinj.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Pasi që avancimi i lojës së futbollit ka ardhur deri te një lojë moderne-bashkëkohore e cila kërkon plotësimin e faktorit të kohës dhe hapësirës, shtyjnë në kërkimin e cilësive të larta individuale tekniko-taktike të futbollistëve për të kryer detyrat kolektive që i obligon loja.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është vlerësimi i disa parametrave antropometrike dhe motorike (të përgjithshme dhe specifike) të futbollistëve të moshës 12 - 13 vjeçarë, të shkollave të futbollit të regjionit të Prizrenit

Vlerësimi i dallimeve të këtyre grupeve të trajtuara në hapësirën e veçorive antropometrike dhe aftësive motorike bazike. Krahasimi i rezultateve të fituara nga të dy këto hapësira në mes katër grupeve të trajtuara dhe diskutimi i tyre.

Qëllim dytësor i këtij hulumtimi është që nëpërmes rezultateve të fituara të vërehet se sa është ndikimi i operatorëve dhe stimulatorëve kineziologjikë në ngritjen e aftësive funksionale - motorike, aftësive specifike dhe veçorive antropometrike.

Qëllimi tretësorë i punimit është:

- Vlersimi i karakteristikave antropometrike dhe motorike te futbollistët e rinjë
- Lidhmëria ndërmjet karakteristikave antropometrike dhe motorike.
- Dallimet në antropometri në mes të katër grupeve të trajtuara.
- Dallimet motorike në mes të katër grupeve të trajtuara.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Duke u mbështetur në qëllimin e këtij punimi janë parashtruar këto hipoteza:

Hipoteza 1. Pritet se karakteristikat antropometrike do të kenë shpërndarje normale të rezultateve.

Hipoteza 2. Pritet se ndryshoret motorike do të kenë shpërndarje normale të rezultateve.

Hipoteza 3. Pritet se do të ketë korelacione të vlefshme ndërmjet karakteristikave antropometrike dhe aftësive motorike

Hipoteza 4. Pritet se do të paraqiten ndryshime të theksuara të rezultateve ndërmjet të rinjve 12 - 13 vjeçë, në karakteristikat antropometrike dhe aftësitë motorike.

4. METODAT E HULUMTIMIT

4.1 PËRKUFIZIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT

Në mostrën e hulumtimit janë përfshirë 4 shkolla të futbollit, të rajonit të Prizrenit, të moshës 12 - 13 vjeçarë (± 6 muaj). Shkollat e futbollit janë përfaqsuar me nga 20 futbollistë, mostra ka përfshirë gjithsejtë 80 futbollist të rinjë të cilët i u janë nënshtruar testimit me anë të 13 ndryshoreve.

Të testuarit në këtë hulumtim vullnetarisht kanë shpreh dëshirën dhe për pjesëmarrjen e tyre në hulumtim kanë dhënë miratimin e prindit – kujdestarit të tyre.

Shkollat e futbollit pjesëmarrëse në hulumtim kanë qenë:

- **SH.F. BALLKANI**
- **SH.F. DRINI I BARDHË**
- **SH.F. LIRIA**
- **SH.F. RAHOVER**

4.2 NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE

Në këtë hulumtim janë përfshirë 5 ndryshore (variabla) antropometrike:

- 1. ALARTE** - Lartësia e trupit.
- 2. APESHA** - Pesha e trupit.
- 3. APERGJ** - Perimetri i gjoksit
- 4. APERKO** - Perimetri i kofshës.
- 5. APERKE** - Perimetri i kërcirit

4.3 NDRYSHORET MOTORIKE

Në këtë hulumtim janë përfshirë 8 ndryshore motorike:

- 1. MKGJAT** - Kërcim së gjati nga vendi.
- 2. MKELAT** - Kërcim së larti nga vendi.
- 3. MVR10M** - Vrapim 10 m nga starti i lartë
- 4. MVR25M** - Vrapim 25 m nga starti i lartë
- 5. MVR5x10M** - Vrapim 5 x 10 m vajtje ardhje
- 6. MVR50M** - Vrapim 50 m nga starti i lartë
- 7. MKAHAN** - Hapa anash – koordinim lëvizor
- 8. MFEMSHA** - Frekuenca e mbledhjes-shtirirje e muskujve abdominal.

4.4 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE

4.4.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse antropometrike

Ndryshoret antropometrike janë matur sipas mënyrës si vijon:

Lartësia e trupit (ALARTE) – matet me antropometer, entiteti që matet duhet të jetë i zbathur në brekë sportive të qëndroj në bazë të fortë horizontale. Koka e tij duhet të jetë në pozitë ku duhet respektuar Horizontalja e Frankfuritit. Qëndrimi i trupit të entitetit duhet të jetë i relaksuar dhe i drejtë, ndërsaq matësi qëndron në anën e majtë të entitetit. Pasi që e kontrollon pozitën e entitetit dhe të instrumentit (antropometrik), e lëshon krahun horizontal të antropometrit deri në pjesën parietale të kokës (pika më e lartë e kokës – vërtex). Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Foto.1. Lartësia e trupit - ALARTË



2. Pesha e trupit (APESHA) matet me peshore decimale me saktësi deri në 0.1 kg. Peshorja vendoset në sipërfaqe të rrafshët. I testuari vendoset në mes të peshorës duke marrë pozicionin e drejtë. Gjatë matjes kanë të veshur veshje sportive (vetëm në brekë) dhe pas secilës matje peshorja kthehet në zero (0).

Foto.2. Pesha e trupit – APESHA



3. **Perimetri i gjoksit (APERGJ)** - Matet me shirit metrik në të cilin janë të shënuara milimetrat dhe centimetrat. I testuari qëndron në këmbë. Shiriti vendoset në rrafshin horizontal në nivel të artikulationit të katërt kosto-sternal, duke kaluar mbi ulësen e poshtme të shpatullave dhe në përfundim të muskujve pectoralis major. Perimetri matet në fund të nje frymënxjerrje normale. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.

Foto. 3. Perimetri i gjoksit - APERGJ



4. Perimetri i kofshës (APERKO) - Është matur me shirit milimetrik. I maturi qëndron në këmbë me gjymtyrë të poshtme diq të larguara. Shiriti vendoset në të tretën e sipërme të kofshës (gjerësia më e madhe). Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.

Foto. 4. Perimetri i kofshës – APERKO



5. Perimetri i nën gjurit drejtqëndrim (APENGJ) – (ulur në arkën suedeze) Është matë me traken matëse gjysmë plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim. Traka matëse mbështjellët rreth pjesës së nën gjurit të majtë (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet zogut të këmbës dhe pjesës së epërme të tibies. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1cm.

Foto 5. Perimetri i nëngjurit apo kërcirit (AONGJU)



4.4.2 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike

Ndryshoret motorike janë matur sipas mënyrës si vijon:

1. Kërcim së gjati nga vendi – MKGJAT

Instrumentet: Metri metalik, shtegu për vrapim kërcim së gjati.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset me shputa në dysheme, me fytyrë nga drejtimi i kërcimit.

Realizmi i detyrës: I testuari në përkulje të vogël në gjunjë duke e shfrytëzuar edhe hovin e krahëve, realizon kërcimin me të dy këmbët para. Detyra përsëritet tri herë, ndërkaq shënohet rezultati më i mirë.

Vlerësimi: Shënohet rezultati i kërcimit më të gjatë nga vendi i shtytjes deri të gjurmët e pjesës së pasme të shputave në saktësi 1 cm.

Udhëzime të testimit: Kërcimi përsëritet nëse i testuari kërcen në vend para kërcimit para, nëse kërcimi realizohet në një këmbë, nëse pas rënies mbështetet prapa në duar etj.

Foto 6. Kërcim së gjati nga vendi – MKGJVE



2. Kërcim së larti nga vendi – MKELAT

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit. I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime) lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Realizimi i detyrës: I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime). Lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm. Rezultati shënohet me 1 cm.

Vlerësimi: Lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testimit: Të testuarve udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit

Foto 7. Kërcim së larti nga vendi – MKELAT



3. Vrapimi 10 m nga starti i lartë - MVR10M

Instrumentet: Kronometri me 1/10sek

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgaditet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: Pas komandës "gati" nga matësi ndihmës, dhe sinjalit "tash", i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 10m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sek.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. I testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto.8. Vrapim 10m nga stadi i lartë – MVR10M



4. Vrapimi 25m nga starti i lartë – MVR25m

Instrumentet: Kronometri me 1/10sek

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgaditet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizi i detyrës: Pas komandës "gati" nga matësi ndihmës, dhe sinjalit "tash", i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 25m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10sek.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. I testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Fig. 9. Vrapim 25m nga stadi i lartë – MVR25m



5. Vrapimi 5x10 m vajtje-ardhje (me kthim) MVR5X10M

Instrumentet: Instrumente të cilat kanë qenë të nevojshme janë: kronometri me 1/10sek dhe tapat për caktimin e vijës startuese dhe të cakut.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgaditet për vrapim pranë vijës së startit, në pozit të startit të lartë

Realizimi i detyrës: Pas komandës "gati" nga matësi ndihmës dhe sinjalit "tash", i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë prej 10m, prek me shputën e këmbës vijën e cakut dhe kthehet te vija startuese dhe kështu vrapimi përsëritet 5 herë.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet me saktësi 1/10sek.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. I testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Fig. 10 . Vrapimi 5x10 m vajtje-ardhje (me kthim) MVR5X10M



6. Vrapim 50 m nga starti i lartë – MVR50M

Instrumentet: Kronometri me 1/10sek

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgaditet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë

Realizimi i detyrës: Pas komandës "gati" nga matësi ndihmës, dhe sinjalit "tash", i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 50m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10sek.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. I testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Fig. 11. Vrapim 50m nga starti i lartë – MVR50m



7. Hap anash koordinim lëvizor – MKAHAN

Instrumentet: Kronometri, shirit ngjitës me ngjitës me ngjyrë të dallueshme. Dy pjesë të shiritit të ngjitësit me gjatësi 0.5m vendosen në dysheme në largësi 4m paralel njëra me tjetrën.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron afër vijës së nisjes me këmbë të bashkuara, e kthyer tërthorazi me vijën (drejtimin e lëvizjes).

Realizimi i detyrës: I testuari në shenjën "tash" nisët me shpejtësinë më të madhe të mundshme lëvizë me hapa-anash, duke mos i kryqëzuar këmbët, deri te vija tjetër, dhe kthehet në anën tjetër duke mos e ndërruar pozitën e trupit. Subjekti duhet që largësinë 4m ta kalojë 6 herë.

Vlersimi: Kronometri ndalet kur subjekti me njëren këmbë arrin te vija e nisjes. Rezultati shënohet në saktësi prej 1/10sek.

Udhëzime të testuarit: I testuari udhëzimet i merr gjatë demonstrimit të detyrës.

Fig.12. Hap anash koordinim lëvizor - MKAHAN



8. Frekuenca e mbledhje – shtrirje e muskujve abdominal – MFFMSHA

Instrumentet: Kronometri me 1/10sek

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari ka pozitë të shtrirë në shpinë me duar në qafë dhe këmbë të thyera të mbështetura nga treneri

Realizimi i detyrës: Detyra e të testuarit është që brenda 30sek, sa më shpejt që është e mundur, pa ndërprerje ta ngris trupin.

Vlerësimi: Llogaritet numri i ngritjeve të rregullta në kohëzgjatje prej 30 sek.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu ipen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra, (u tregohet ngadalë, për ngritjet e rregullta dhe ato jo të rregullta). I testuari bënë disa tentime provuese.

Fig. 13. Frekuenca e mbledhje-shtrirje muskujve abdominal- MFFMSHA



4.5 MËNYRA E ZBATIMIT TË HULUMTIMIT

Matjet antropometrike dhe motorike janë kryer në fund të muajit nëntor dhe fillim të muajit dhjetor të vitit 2015.

Matjet antropometrike do të bëhen në hapësirat e zveshtoreve të shkollave të futbollit, kurse matjet motorike në terrenet sportive (fushave të lojës) të shkollave përkatëse.

Matjet antropometrike me grupet e futbollistëve të rinjë do të bëhen në kohën e stërvitjeve të shkollave të futbollit. Matjet do të bëjnë bashkë me ndihmën e një grupi kolegësh profesorë të Kulturës Fizike dhe Sportit që kanë një përvojë të mirë në këso lloj matjesh. Të gjitha matjet parashihet të bëhen në kushte të njëjta infrastrukturore, higjienike, temperaturë përafërsisht të njëjtë si dhe me rekuizita të njëjta sportive.

Testi do të përsëritet deri në 3 herë për disa variabla (ndryshore) kurse për disa vetëm një herë, varësisht prej karakteristikës së testit, kurse shënohet rezultati më i mirë apo më i saktë.

4.6 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Sipas qëllimit të parashtruar dhe hipotezave të përpiluara aplikohen parametrat statistikore dhe metodat kuantitative të cilat vërtetojnë synimet dhe objektivat e këtij punimi. Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi do të zgjidhen procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që hulumtohen.

Për çdo ndryshore antropometrike të volumit trupor, ndryshore motorike të forcës eksplozive dhe teste situacionale do të llogariten vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qendrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)

2. Lakorja e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë „skjunis”, dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës "kurtozis".

3. Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe testeve motorike në hapësirën manifeste, do të bëhet me anë të analizës bivariante të korelacionit sipas Pearsonit.

4. Për përcaktimin e dallimit të ndryshoreve antropometrike dhe motorike në mes grupeve apo ekipeve është aplikuar analiza univariante e variancës ANOVA

5 . INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

5.1 PËRSHKRIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR

5.1.1 Përshkrimi i parametrave themelor statistikor SH.F. "BALLKANI" Therandë

Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike të futbollistët e rinj të grupmoshat 12-13 vjeçare në futboll SH.F. "BALLKANI" Therandë janë të paraqitura në tabelën 1. Sa i përket parametrave themelor statistikor antropometrike dhe motorike, sidomos testi i asimetrisë (skewness) tek kjo grupmoshë e të testuarve vërejmë se rezultatet e ndryshoreve antropometrike nuk kanë shmangie nga distribucioni normal apo nuk kanë asimetri të theksuar. Ndryshoret motorike, kërcim së gjati nga vendi (MKGJAT) dhe Frekuenca e mbledhjes-shtrirje e muskujve abdominal (MFEMSHA) kanë asimetri të theksuar, që do të thotë se futbollistët e rinj kanë rezultate të ndryshme dhe dallohen në mes veti.

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike të futbollistët e rinj të grupmoshave 12-13 vjeçar të Shkollës së futbollit "BALLKANI" Therandë

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALARTE	20	140.00	157.00	147.1000	4.82210	.545	-.487
APESHA	20	28.00	49.00	37.1000	5.68377	.510	-.405
APERGJ	20	59.30	74.90	67.4850	4.77684	-.196	-1.052
APERKO	20	30.70	47.40	39.3800	5.30844	-.310	-1.045
APERKO	20	24.50	35.60	30.1400	3.10948	-.039	-.779
MKGJAT	20	135.00	149.00	140.5000	3.60555	1.104	1.665
MVR10M	20	2.15	2.95	2.4605	.16554	.983	3.283
MVR25M	20	4.25	4.95	4.6860	.17518	-.735	.763
MVR5x10M	20	14.30	15.25	14.7590	.28384	.038	-1.069
MVR50M	20	8.30	9.70	8.9845	.37482	-.105	-.465
MKELAT	20	20.00	28.00	22.7500	2.04875	.497	.759
MKAHAN	20	12.95	14.40	13.8760	.37884	-.519	.145
MFEMSHA	20	38.00	54.00	42.7500	3.47737	1.693	4.977

Shumica e rezultateve antropometrike të fituara janë negative (hipokurtike) sikurse që janë ndryshoret: perimetri i gjoksit (APERGJ), perimetri i kofshës (APERKO) dhe perimetri i kërcirit (APERKO) që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të ulëta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të larta. Parametrat antropometrik, lartësia trupore (ALARTE) dhe pesha e trupit (APESHA) janë pozitive (epikurtike) që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të larta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të ulëta.

Nga parametrat motorik shumica e rezultateve të fituara janë pozitive (epikurtike), kërcim së gjati nga vendi (MKGJAT), vrapimi 10m nga starti i lartë (MVR10M), vrapimi 5x10m vajtje–ardhje (MVR5x10), frekuenca e mbledhjes-shtrirje e muskujve abdominal (MFEMSHA), kërcim së larti nga vendi (MKELAT) që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të larta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të ulëta.

Nga parametrat motorik numrin më të vogël të rezultateve të fituara që janë negative (hipokurtike) e përbëjnë ndryshoret, vrapim 25 m nga starti i lartë (MVR25M), vrapim 50m nga starti i lartë (MVR50M) dhe hapat anash – kordinimi levizor (MKAHAN), që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të ulëta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të larta.

5.1.2 Përshkrimi i parametrave themelor statistikor SH.F. " DRINI I BARDHË" Prizren

Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te futbollistët e rinj te grupmoshat 12-13 vjeçare në futboll SH.F. "DRINI I BARDHË" janë të paraqitura në tabelën 2. Sa i përket parametrave themelor statistikor antropometrike dhe motorike, sidomos testi i asimetrisë (skewness), tek kjo grupmoshë vërejmë se rezultatet e ndryshoreve antropometrike, shumica prej tyre nuk kanë shmangie nga distribucioni normal ose nuk kanë asimetri të theksuar. Ndryshorja antropometrike pesha e trupit (APESHA) dhe ndryshorja motorike, hapat anash – kordinimi levizor (MKAHAN) kanë asimetri të theksuar, që do të thotë se futbollistët e rinj kanë rezultate të ndryshme dhe paraqiten si grup heterogjen.

Tabela 2. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te futbollistët e rinj të grupmoshave 12-13 vjeçar të Shkollës së futbollit " DRINI I BARDHË" Prizren

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALARTE	20	141.00	158.00	146.7000	4.72507	.861	.119
APESHA	20	30.50	49.00	36.6500	5.25182	1.031	.300
APERGJ	20	59.10	73.70	65.9650	3.79269	.221	-.498
APERKO	20	30.50	46.50	37.5250	4.01036	.488	-.130
APERKE	20	25.10	35.80	28.9000	3.06388	.585	-.377
MKGJAT	20	135.00	145.00	140.1000	2.91818	-.053	-.964
MVR10M	20	2.20	2.65	2.4695	.14587	-.768	-.555
MVR25M	20	4.35	4.87	4.5950	.15480	.179	-.739
MVR5x10M	20	14.20	15.05	14.6200	.26422	.187	-1.150
MVR50M	20	8.20	9.35	8.7720	.30619	-.090	-.191
MKELAT	20	20.00	27.00	22.7500	1.71295	.432	.699
MKAHAN	20	12.95	14.50	14.0070	.37383	-1.335	2.036
MFEMSHA	20	36.00	50.00	41.3000	3.51089	.590	.332

Shumica e rezultateve antropometrike, të gjitha ndryshoret antropometrike të fituara janë pozitive (epikurtike) sikurse që janë ndryshoret: perimetri i gjoksit (APERGJ), perimetri i kofshës (APERKO), perimetri i kërcirit (APERKO), lartësia trupore (ALARTE) dhe pesha e trupit (APESHA) janë pozitive (epikurtike) që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të larta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të ulëta.

Nga parametrat motorik gjysma e rezultateve të fituara janë pozitive (epikurtike), Vrapim 25 m nga starti i lartë (MVR25M), vrapimi 10m nga starti i lartë (MVR10M), vrapimi 5x10m vajtje–ardhje (MVR5x10), kërcim së larti nga vendi (MKELAT) dhe frekuenca e mbledhjes-shtrirje e muskujve abdominal (MFEMSHA), që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të larta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të ulëta.

Nga parametrat motorik gjysma tjetër e rezultateve të fituara që janë negative (hipokurtike) e përbëjnë ndryshoret, kërcim së gjati nga vendi (MKGJAT), vrapim 10m nga starti i lartë (MVR 10M), vrapim 50m nga starti i lartë (MVR50M) dhe hapat anash – koordinimi lëvizor (MKAHAN), që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të ulëta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të larta.

5.1.3 Përshkrimi i parametrave themelor statistikor SH.F. "ILIRIA" Prizren

Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te futbollistët e rinj te grupmoshat 12-13 vjeçare në futboll SH.F. "LIRIA" Prizren janë të paraqitura në tabelën 3. Sa i përket parametrave themelor statistikor antropometrike dhe motorike, sidomos testi i asimetrisë (skewness) tek kjo grupmoshë vërejmë se rezultatet e ndryshoreve antropometrike, të gjitha nga këto ndryshore nuk kanë shmangie nga distribucioni normal ose nuk kanë asimetri të theksuar. Futbollistët e rinjë te kjo grupmoshë të kësaj ekipe kanë rezultate pothuajse të ngjashme dhe zhvillimi morfologjik dhe aftësitë motorike të tyre pothuajse janë të ngjashme edhe paraqiten si grup homogjen pa dallime të theksuara.

Tabela 3. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te futbollistët e rinj të grupmoshave 12-13 vjeçar të Shkollës së futbollit "LIRIA" Prizren

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALARTE	20	141.00	156.00	146.6000	4.44143	.720	-.471
APESHA	20	30.00	48.00	37.2750	5.43738	.528	-.799
APERGJ	20	58.40	72.50	65.2050	4.09717	.037	-.768
APERKO	20	30.10	43.50	36.6050	3.85316	-.013	-.587
APERKE	20	24.50	33.50	29.9500	2.35048	-.787	.860
MKGJAT	20	136.00	145.00	140.8000	2.87640	-.028	-1.181
MVR10M	20	2.25	2.75	2.4635	.11926	.158	.739
MVR25M	20	4.35	4.95	4.6945	.18016	-.648	-.378
MVR5x10M	20	14.25	15.25	14.7485	.30363	-.265	-.825
MVR50M	20	8.48	9.85	9.0115	.35945	.925	.597
MKELAT	20	20.00	26.00	22.7500	1.61815	.119	-.832
MKAHAN	20	12.95	14.55	13.9985	.41441	-.949	.843
MFEMSHA	20	37.00	48.00	41.5000	2.85620	.429	-.265

Shumica e rezultateve antropometrike, të fituara nga matjet janë pozitive (epikurtike) sikurse që janë ndryshoret: lartësia trupore (ALARTE), pesha e trupit (APESHA) dhe perimetri i gjoksit (APERGJ) që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të larta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të ulëta.

Rezultatet antropometrike të parametrave tjerë antropometrik, të fituara nga matjet janë negative (hipokurtike) sikur që janë: perimetri i kofshës (APERKO) dhe perimetri i kërcirit (APERKE), që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të ulëta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të larta.

Nga parametrat motorik gjysma e rezultateve të fituara janë pozitive (epikurtike), vrapimi 10m nga starti i lartë (MVR10M), vrapim 50m nga starti i lartë (MVR50M) kërcim së larti nga vendi (MKELAT) dhe frekuenca e mbledhjes-shtrirje e muskujve abdominal. (MFEMSHA), që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të larta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të ulëta.

Nga parametrat motorik gjysma tjetër e rezultateve të fituara që janë negative (hipokurtike) e përbëjnë ndryshoret, kërcim së gjati nga vendi (MKGJAT), Vrapim 25 m nga starti i lartë (MVR25M), vrapimi 5x10m vajtje–ardhje (MVR5x10), dhe hapat anash – koordinimi lëvizor (MKAHAN), që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të ulëta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të larta.

5.1.4 Përshkrimi i parametrave themelor statistikor SH.F. "RAHOVER" Rahovec

Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te futbollistët e rinj te grupmoshat 12-13 vjeçare në futboll SH.F. "RAHOVER" Rahovec janë të paraqitura në tabelën 4. Sa i përket parametrave themelor statistikor antropometrike dhe motorike, sidomos testi i asimetrisë (skewness) tek kjo grupmoshë vërejmë se rezultatet e ndryshoreve antropometrike, të gjitha nga këto ndryshore nuk kanë shmangie nga distribucioni normal ose nuk kanë asimetri të theksuar. Futbollistët e rinj te kjo grupmoshë të kësaj ekipe kanë rezultate pothuajse të ngjashme dhe zhvillimi morfologjik dhe aftësitë motorike të tyre pothuajse janë të ngjashme edhe paraqiten si grup homogjen pa dallime të theksuara.

Tabela 4. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te futbollistët e rinj të grupmoshave 12-13 vjeçar të Shkollës së futbollit "RAHOVER" Rahovec

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALARTE	20	140.00	159.00	146.9500	5.15522	.754	.092
APESHA	20	27.00	52.00	36.9000	6.78931	.502	-.279
APERGJ	20	60.10	77.10	67.9250	5.40096	.128	-1.176
APERKO	20	28.50	50.10	40.1500	6.82715	-.338	-1.137
APERKE	20	25.70	38.50	30.9100	3.62025	.260	-.871
MKGJAT	20	135.00	150.00	141.1000	4.08978	.808	.075
MVR10M	20	2.00	2.57	2.3220	.18381	-.456	-1.110
MVR25M	20	4.25	5.05	4.6895	.22116	-.553	-.338
MVR5x10M	20	14.10	15.94	14.7385	.50468	.759	.067
MVR50M	20	7.97	10.15	9.0020	.58869	.333	-.031
MKELAT	20	20.00	31.00	23.6500	3.11659	.965	.601
MKAHAN	20	12.50	14.50	13.6285	.60239	-.785	-.188
MFEMSHA	20	30.00	58.00	43.4500	7.11170	.437	.084

Shumica e rezultateve antropometrike, të fituara nga matjet janë pozitive (epikurtike) sikurse që janë ndryshoret: lartësia trupore (ALARTE), pesha e trupit (APESHA), perimetri i gjoksit (APERGJ) dhe perimetri i kërcirit (APERKE), që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të larta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të ulëta.

Rezultatet antropometrike të parametrave tjerë antropometrik, të fituara nga matjet janë negative (hipokurtike) sikur që është perimetri i kofshës (APERKO) që do të thotë se mesatarja aritmetikore e kësaj ndryshore është më e ulëta dhe shumica e rezultateve të kësaj ndryshore antropometrike janë më të larta.

Nga parametrat motorik shumica e rezultateve të fituara janë pozitive (epikurtike), kërcim së gjati nga vendi (MKGJAT), vrapimi 5x10m vajtje–ardhje (MVR 5x10), vrapim 50m nga starti i lartë (MVR50M), kërcim së larti nga vendi (MKELAT) dhe frekuenca e mbledhjes-shtrirje e muskujve abdominal (MFEMSHA), që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të larta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të ulëta.

Nga parametrat motorik gjysma tjetër e rezultateve të fituara që janë negative (hipokurtike) e përbëjnë ndryshoret, vrapimi 10m nga starti i lartë (MVR10M), vrapim 25 m nga starti i lartë (MVR25M), dhe hapat anash – koordinimi lëvizor (MKAHAN), që do të thotë se mesataret e tyre aritmetikore janë më të ulëta dhe shumica e rezultateve të tyre janë më të larta.

6 KOEFICIENTËT E KORELACIONIT NË MES NDRYSHOREVE MORFOLOGJIKE DHE MOTORIKE

6.1 Koeficientë e korelacionit të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te futbollistët e rinj të ekipit SH.F "BALLKANI" Therandë

Matrica e interkorelacionit e ndryshoreve antropometrike dhe motorike te grupmoshat 12-13 vjeçare te futbollistët e rinjë të ekipit SH.F "BALLKANI" Therandë është e paraqitur në tabelën 5. Koeficientët e korelacionit tregojnë se në mes ndryshoreve antropometrike ekziston një korrelacion i rëndësishëm statistikor në nivel të rëndësisë statistikore $p=0.01$. Shikuar në tërësi, një ndërlidhje e tillë edhe është pritur kur dihet se të gjitha ndryshoret antropometrike i përkasin masës dhe volumenit truporë, përpos ndryshores antropometrike, lartësia e trupit (ALARTE) që i përket dimensionit longitudinal.

Ndryshorja motorike, kërcim së gjati nga vendi (MKGJAT) nuk qëndron në korelacion të rëndësishëm statistikor me asnjë ndryshore antropometrike as motorike.

Ndryshorja motorike, Vrapim 10m nga starti i lartë (MVR10M) qëndron në korelacion të rëndësishëm statistikor në nivel $p=0.05$ me ndryshoret antropometrike pesha e trupit (APESHA), perimetri i gjoksit (APERGJ), perimetri i kërcirit (APERKE) dhe ndryshoren motorike hapa anash – koordinim lëvizor (MKAHAN).

Ndryshorja motorike, vrapim 25m nga starti i lartë (MVR25M) qëndron në korelacion të rëndësishëm statistikor në nivel $p=0.05$ me ndryshoret antropometrike lartësia e trupit (ALARTE), pesha e trupit (APESHA), perimetri i gjoksit (APERGJ), dhe ndryshoren motorike vrapim 50m nga starti i lartë (MVR50M).

Ndryshorja motorike, vrapim 5x10m vajtje ardhje (MVR5x10M) qëndron në korelacion të rëndësishëm statistikor në nivel $p=0.05$ me ndryshoret antropometrike lartësia e trupit (ALARTE), pesha e trupit (APESHA) dhe me asnjë ndryshore motorike.

Ndryshorja motorike, vrapim 50m nga starti i lartë (MVR50M) qëndron në korelacion të rëndësishëm statistikor në nivel $p=0.05$ me ndryshoret antropometrike pesha e trupit (APESHA), perimetri i gjoksit (APERGJ), perimetri i kërcirit (APERKE) dhe ndryshoren motorike vrapim 50m nga starti i lartë (MVR50M).

